



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: . .2024

Nr:

Ora: 00:00

**PROJEKTVENDIM**

**PËR**  
**MIRATIMIN E “PROGRAMIT TË EDUKIMIT, INFORMIMIT DHE**  
**NDËRGJEGJËSIMIT TË ZGJEDHËSVE NGA JASHTË VENDIT PËR ZGJEDHJET**  
**PËR KUVEND TË VITIT 2025”**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “g” dhe 2, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**VENDOS:**

1. Të miratoj “Programin për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve nga jashtë vendit për zgjedhjet për Kuvend të vitit 2025”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: \_.\_.2024 Nr:\_  
Ora:00:00



“Për miratimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimin të zgjedhësve nga jashtë vendit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

**Programi për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve nga jashtë vendit**

**Përmbledhje ekzekutive**

Programi për informimin, edukimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve jashtë vendit për zgjedhjet për Kuvendin 2025 përcakton objektivat dhe hapat konkrete që do të ndërmerren për realizimin e procesit të votimit nga shtetasit me të drejtë vote, të cilët, në ditën e zgjedhjeve për Kuvendin, ndodhen jashtë vendit. Në të njëjtën kohë, programi pasqyron punën dhe angazhimin e KQZ-së, si institucioni që drejton, mbikëqyr dhe është përgjegjës për procesin e përgatitjes së kushteve dhe zbatimin e masave që mundësojnë votimin nga jashtë vendit në zgjedhjet për Kuvend të vitit 2025.

Duke qenë se procesi i votimit nga jashtë vendit zhvillohet për herë të parë, programi për edukimin e zgjedhësve jashtë vendit synon të ndërgjegjësojë qytetarët shqiptarë jashtë vendit për rëndësinë e votës së tyre në përzgjedhjen e anëtarëve të organit më të lartë qeverisës, përmes informimit dhe edukimit të tyre për votimin me sukses në këto zgjedhje.

Për realizimin e programeve ndërgjegjësuese dhe edukuese, KQZ-ja do të bashkëpunojë me partnerët vendas dhe ndërkombëtarë, përfshirë shoqërinë civile. Përfshirja e tyre në realizimin e këtyre programeve përmes ekspertizës, kontributit dhe mbështetjes vlerësohen si komponentë të rëndësishëm në mbarëvajtjen e këtij operacioni, i cili jo vetëm zhvillohet për herë të parë, por synon të mos përjashtojë asnjë shtetas që shpreh dëshirën për të votuar nga jashtë vendit, pavarësisht vendndodhjes gjeografike.

## **Qëllimi i programit**

Programi për edukimin zgjedhor të shtetasve jashtë vendit për zgjedhjet për Kuvendin 2025, ka për qëllim të informojë dhe të ndërgjegjësojë zgjedhësit mbi rëndësinë e një pjesëmarrjeje sa më të gjerë dhe mbi komponentë të ndryshëm të këtij procesi zgjedhor.

Në mënyrë specifike programi ka si qëllim të informojë këtë kategori votuesish në lidhje me mundësinë dhe rëndësinë për të votuar, t'i edukojë për procesin e votimit, duke filluar me procedurën e regjistrimit për të qenë votues; informojë dhe edukojë zgjedhësit mbi verifikimin e emrit në listën e zgjedhësve nga jashtë vendit, informojë se si do t'u dërgohet fleta e votimit, edukojë ata për plotësimin korrekt të fletës së votimit, informojë dhe edukojë zgjedhësit se ku dhe kur duhet të dërgohet fleta e votimit, informojë ata për mënyrën se si do të numërohet dhe si do të llogaritet vota e tyre në tabelën e rezultateve të zonës zgjedhore përkatëse.

## **Objektivat kryesorë të programit janë:**

1. Të informojë zgjedhësit jashtë vendit për përfshirjen për herë të parë në procesin e votimit për zgjedhjet për Kuvend të vitit 2025.
2. Të edukojë këtë kategori zgjedhësish lidhur me procedurën e regjistrimit në Platformën Elektronike të Regjistrimit (PER), për t'u përfshirë në listën e zgjedhësve që votojnë jashtë vendit.
3. Të informojë dhe edukojë zgjedhësit lidhur me verifikimin e emrit në listën e zgjedhësve nga jashtë vendit.
4. Të informojë zgjedhësit nga jashtë vendit për plotësimin korrekt të fletës së votimit dhe kthimin mbrapsht të saj.

5. Të informojë zgjedhësit për mënyrën se si do administrohet fleta e tyre e votimit, si do numërohet, si dhe llogaritja në tabelën e rezultateve të zonës zgjedhore përkatëse.

**Audienca e synuar:** çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote që ndodhet jashtë vendit në datën e zgjedhjeve për Kuvend të vitit 2025.

### **Sfidat e Programit**

Implementimi për herë të parë i këtij procesi mbart një sfidë në vetvete për përmbushjen e objektivave brenda afateve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor. Përfshirja në këtë fushatë ndërgjegjësimit dhe informimi i një numri sa më të madh qytetarësh nga ky grup i synuar votuesish, përbën një tjetër sfidë.

Në bazë të të dhënave zyrtare, zgjedhësit që ndodhen me banim jashtë vendit janë të shumtë në numër, por dhe me një shpërndarje gjeografike të gjerë, çka e bën përfshirjen e tyre në zgjedhje një sfidë të shumëfishtë.

Në anën tjetër, afatet e ngushta kohore për përmbushjen e të gjitha detyrimeve ligjore që rrjedhin nga Kodi Zgjedhor i RSH-së, pamjaftueshmëria e burimeve njerëzore dhe financiare për realizimin e të gjitha pjesëve të programit, dhe aspekteve që lidhen me to, përfaqësojnë sfida domethënëse në përmbushjen me sukses të misionit të KQZ-së.

#### **1. Të informojë zgjedhësit jashtë vendit për përfshirjen për herë të parë në procesin e votimit për zgjedhjet për Kuvend të vitit 2025.**

Ky objektivi ka për qëllim informimin e zgjedhësve nga jashtë vendit mbi ndryshimet në Kodin Zgjedhor, në të cilat përfshihet për herë të parë votimi i shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit. Ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit i tyre për ushtruar të drejtën e votës për zgjedhjet për Kuvend të vitit 2025.

**Grupi ku adresohet:** çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote që ndodhet jashtë vendit në datën e zgjedhjeve për Kuvend të vitit 2025.

#### **▪ Mjetet e komunikimit**

- a) **App KQZ** (Nëpërmjet aplikacionit mund të gjendet sesioni “votues nga jashtë ” ku çdo zgjedhës mund të informohet për përfshirjen në procesin e votimit nga jashtë).

- b) **Ëeb KQZ** (Në ëeb-site e KQZ-së do të publikohet i gjithë informacioni mbi procesin e votimit nga jashtë).
  - c) **Media sociale** (Do të postohen në rrjetet sociale informacione me karakter informues mbi procesin për herë të parë të votimit nga jashtë vendit).
  - d) **Spote televizive** (Do të transmetohen spote informuese mbi procesin e votimit nga jashtë vendit).
  - e) **Postera dhe fletëpalosje në përfaqësi diplomatike dhe pika kufitare** (Do të vendosen postera dhe fletëpalosje informuese mbi procesin e votimit nga jashtë vendit).
  - f) **Takime me zgjedhësit nga jashtë të KSHZ** (Do zhvillohen disa takime informuese jashtë vendit, ku ka prezencë më të madhe të shtetasve shqiptarë më të drejtë vote, si dhe të organizatave të diasporës)
- **Periudha e zhvillimit të kësaj fushate:** Nëntor 2024 – Prill 2025

**2. Të edukojë këtë kategori zgjedhësish lidhur me procedurën e regjistrimit në Platformën Elektronike të Regjistrimit (PER), për t'u përfshirë në listën e zgjedhësve që votojnë jashtë vendit.**

Ky objektivi ka për qëllim të informojë dhe ndërgjegjësojë zgjedhësit mbi rregullat e regjistrimit në Platformën Elektronike të Regjistrimit (PER). Hapat që duhet të ndjekë zgjedhësi për t'u regjistruar, orientim se si duhet të përdori PER dhe dokumentat që duhet të dorëzojë për të vërtetuar qëndrimin e tij jashtë vendit.

**Grupi ku adresohet:** çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote që ndodhet jashtë vendit në datën e zgjedhjeve për Kuvend të vitit 2025.

- **Mjetet e komunikimit**

- a) **Spote televizive** (Do të transmetohen spote televizive në televizionet kombëtare pjesë e platformave digjitale mbi mënyrën e përdorimit të platformës PER dhe hapave që duhen ndjekur për t'u regjistruar).

- b) **Media sociale** (Do të postohen në këto rrjete mesazhe informuese dhe video tutorial mbi mënyrën e përdorimit të platformës PER dhe hapave që duhen ndjekur për t'u regjistruar).
- c) **App KQZ** (Nëpërmjet aplikacionit, tek sesioni “votues nga jashtë”, mund të gjenden informacione mbi mënyrën e përdorimit të platformës PER dhe hapave që duhen ndjekur për t'u regjistruar).
- d) **Ëëb KQZ** ( në ëëbsite e KQZ-së, tek sesioni “votues nga jashtë” do të mund të konsultohen informacione me karakter informues dhe edukues mbi përdorimin e platformës PER).
- e) **AI** (ndihmë/suport për zgjedhësin duke përdorur asistent digjital (ang. Artificial intelligence)
- f) **Postera dhe fletëpalosje në përfaqësi diplomatike dhe pika kufitare** (Do të vendosen postera dhe fletëpalosje informuese mbi mënyrën e përdorimit të platformës PER).

- **Periudha e transmetimit:** Nëntor 2024- Prill 2025

### **3. Të informojë dhe edukojë zgjedhësit lidhur me verifikimin e emrit në listën e zgjedhësve nga jashtë vendit.**

Ky objektivi ka për qëllim informimin dhe edukimin e zgjedhësve nga jashtë vendit në lidhje me procesin e verifikimit të emrit në listën e zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit. Njohja me afatet e publikimit të listave emërore të zgjedhësve nga jashtë vendit, si dhe afatet për rregullimin e pasaktësive në rastet kur regjistrimi ka pasaktësi.

**Grupi ku adresohet:** çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote që ndodhet jashtë vendit dhe që është regjistruar në platformën PER.

- **Mjetet e komunikimit**

- a) **App KQZ** (Nëpërmjet aplikacionit mund të gjendet sesioni “votues nga jashtë ”; çdo zgjedhës nga jashtë vendit që është regjistruar në platformën PER mund të informohet mbi procesin e verifikimit të emrit në listë).
- b) **Ëëb KQZ** (Në ëëbsite e KQZ-së, tek sesioni “votues nga jashtë”, çdo zgjedhës nga jashtë vendit që është regjistruar në platformën PER mund të informohet mbi procesin e verifikimit të emrit në listën e zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit).

- c) **Media sociale** (Do të postohen në rrjetet sociale informacione me karakter informues mbi procesin e verifikimit të emrit të zgjedhësit nga jashtë vendit që është regjistruar në platformën PER).
  - d) **Spote televizive** (Do të transmetohen spote informuese në televizionet kombëtare pjesë e platformave digjitale mbi procesin e verifikimit të emrit të zgjedhësit nga jashtë vendit që është regjistruar në platformën PER).
  - e) **Postera dhe fletëpalosje në përfaqësi diplomatike dhe pika kufitare** (Do të vendosen postera dhe fletëpalosje informues mbi procesin e verifikimit të emrit të zgjedhësit nga jashtë vendit, që është regjistruar në platformën PER).
- **Periudha e zhvillimit të kësaj fushate:** sipas afateve të parashikuara në Kodin Zgjedhor

#### **4. Të informojë zgjedhësit nga jashtë vendit për plotësimin korrekt të fletës së votimit dhe kthimin mbrapsht të saj.**

Ky objektivi ka për qëllim informimin dhe edukimin e zgjedhësve, të cilët janë tashmë pjesë e listës së zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit mbi përmbajtjen e “setit” me zarfin, fletën e votimit, së bashku me çdo material zgjedhor dhe material informativ. Pasi zgjedhësi ka marrë dhe plotësuar fletën e votimit, informohet në lidhje me mënyrën se si dhe kur do të dërgohet fleta e votimit në KQZ.

**Grupi ku adresohet:** Çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote që ndodhet jashtë vendit në datën e zgjedhjeve për Kuvend të vitit 2025, që është regjistruar me sukses në platformën PER dhe që është pjesë e listës së zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit.

- **Mjetet e komunikimit**

- a) **App KQZ** (Nëpërmjet aplikacionit mund të gjendet sesioni “votues nga jashtë ”; çdo zgjedhës nga jashtë vendit që është pjesë e listës së zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit mund të informohet mbi hapat që duhet të ndjekë për të plotësuar në mënyrë korrekte fletën e votimit dhe dërgimin e saj në KQZ).
- b) **Ëëb KQZ** (Në ëëbsite e KQZ-së, tek sesioni “votues nga jashtë”, çdo zgjedhës nga jashtë vendit që është pjesë e listës së zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit mund të informohet

mbi hapat që duhet të ndjeki për të plotësuar në mënyrë korrekte fletën e votimit dhe dërgimin e saj në KQZ).

- c) **Media sociale** (Do të postohen në rrjete sociale informacione me karakter informues mbi hapat që duhet të ndjeki për të plotësuar në mënyrë korrekte fletën e votimit dhe dërgimin e saj në KQZ, çdo zgjedhës që është pjesë e listës së zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit).
  - d) **Spote televizive** (Do të transmetohen spote informuese në televizionet kombëtare pjesë e platformave digjitale mbi hapat që duhet të ndjeki për të plotësuar në mënyrë korrekte fletën e votimit dhe dërgimin e saj në KQZ, çdo zgjedhës që është pjesë e listës së zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit).
  - e) **Fletëpalosje në përfaqësi diplomatike dhe pika kufitare** (Do të shpërndahen fletëpalosje informuese mbi hapat që duhet të ndjeki për të plotësuar në mënyrë korrekte fletën e votimit dhe dërgimin e saj në KQZ, çdo zgjedhës që është pjesë e listës së zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit).
  - f) **E-banner** (do të transmetohen reklama elektronike në mediat online me përmbajtje informuese mbi hapat që duhet të ndjeki për të plotësuar në mënyrë korrekte fletën e votimit dhe dërgimin e saj në KQZ, çdo zgjedhës që është pjesë e listës së zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit).
- **Periudha e zhvillimit të kësaj fushate:** 60 ditë përpara datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve

## **6. Të informojë zgjedhësit për mënyrën se si do administrohet fleta e tyre e votimit, si do numërohet, si dhe llogaritja në tabelën e rezultateve të zonës zgjedhore përkatëse.**

Ky objektivi ka për qëllim të informojë zgjedhësit nga jashtë vendit që kanë ushtruar të drejtën e votës mbi mënyrën se si do të numërohet dhe përllogaritet fleta e tyre e votimit në rezultatin e zonës zgjedhore përkatëse.

**Grupi ku adresohet:** Çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote që ndodhet jashtë vendit në datën e zgjedhjeve për Kuvend të vitit 2025, që ka ushtruar të drejtën e votës.

### ▪ **Mjetet e komunikimit**

- a) **App KQZ** (Nëpërmjet aplikacionit mund të gjendet sesioni “votues nga jashtë”; çdo zgjedhës nga jashtë vendit që ka ushtruar të drejtën e votës mund të informohet mbi mënyrën se si do të numërohet dhe përllogaritet fleta e tyre e votimit në rezultatin e



zonës zgjedhore përkatëse).

- b) **Ëeb KQZ** (Në ëeb-site e KQZ-së, tek sesioni “votues nga jashtë”, çdo zgjedhës nga jashtë vendit që ka ushtruar të drejtën e votës mund të informohet mbi mënyrën se si do të numërohet dhe përlllogaritet fleta e tyre e votimit në rezultatin e zonës zgjedhore përkatëse).
  - c) **Media sociale** (Do të postohen në rrjete sociale informacione me karakter informues mbi mënyrën se si do të numërohet dhe përlllogaritet fleta e votimit në rezultatin e zonës zgjedhore përkatëse, të votuesve nga jashtë vendit).
  - d) **Spote televizive** (Do të transmetohen spote informuese në televizionet kombëtare pjesë e platformave digjitale mbi mënyrën se si do të numërohet dhe përlllogaritet fleta e votimit në rezultatin e zonës zgjedhore përkatëse, të votuesve nga jashtë vendit).
- **Periudha e zhvillimit të kësaj fushate:** 60 ditë përpara datës së zgjedhjeve deri në postimin e fletëve të votimit.

## **MJETET QË DO TË PËRDOREN PËR FUSHATËN E EDUKIMIT DHE INFORMIMIT**

1. Sesione edukuese/informuese me zgjedhësit
2. Spote televizive
3. E- banner
4. Fletëpalosje
5. Media sociale
6. AI
7. Postera